Në programin për punën e arsimtarëve, drejtori dhe psikologu, si dhe në realizimin e aktiviteteve kulturore dhe arsimore, vëmendje e posaçme i kushtoi bashkëpunimit me prindërit. Ky bashkëpunim më së shpeshti do të realizohet gjatë takimeve të përditshme dhe bisedave, takime të prindërve, ndërsa veçanërisht nëpërmjet programit për punën e kujdestarit të klasës. Në këto takime dhe biseda do të trajtohen pyetjet direkte që janë të lidhura me jetën dhe punën e nxënësve në shkollë (suksesi, disciplina), pastaj, përmirësimi i kushteve për punë në shkollë dhe standardi i nxënësit, ushqimi etj. Janë të planifikuara edhe punëtori për prindërit ligjërata të tipizuara dhe të trajtuarit e temave nëpërmjet lajmërimeve, flaerave, pllakate, broshura, gazeta shkollore si dhe punë këshilluese dhe konsultative – individuale dhe në grupe.

Pas miratimit të programit të shkollës nga ana e themeluesit, përgatiti broshurë në të cilën shkurtimisht informohen prindërit për përmbajtjen e planit vjetor për punën e shkollës.

Duhet të theksohet bashkëpunimi me këshillin e prindërve dhe angazhimi i shkollës ajo të thellohet sepse kemi qëllime të përbashkëta, ngritja e personalitetit të cilët do të bartin barrën e ngritjes së shtetit tonë.

XVII. KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN DHE PROMOVIMI I SHKOLLËS

17.1. Komunikimi me bashkësinë lokale

Këtë fushë programore e kemi realizuar me qëllim që t'i vendosim të gjitha resurset e bashkësisë lokale në funksion të shkollës, të cilat janë në interes për punën edukativo- arsimore. Nëpërmjet kësaj fushe i realizojmë detyrat e mëposhtme :

- shfrytëzimin e mundësive materiale të bashkësisë lokale për përparimin e aktivitetit të shkollës;
- pasurimin e punës edukative-arsimore si rezultat i shfrytëzimit të mundësive nga fusha e kulturës, sportit e të ngjashme ;
- organizime të manifestimeve të përbashkëta kulturore-artistike, edukative, sportive dhe manifestime tjera me shkollat tjera të komunës;
- pasurimin e punës edukative-arsimore si rezultat i shkëmbimit të diturive, mendimeve dhe përvojave me kuadrin arsimor të shkollave tjera të komunës;

Me qëllim të realizimit të qëllimeve të parapara shkolla në nivel të lartë e mban komunikimin me vetëqeverisjen lokale dhe popullatën vendase. Komunikimi më së shpeshti është i menjëhershëm dhe gojor, por kontaktet zyrtare të mbështetura me dokumentacion realizohen me komunikim elektronik dhe të shkruar. Parashihet të relizohen mbledhje, takime, debate, tribuna në përputhje me programet e duhura që janë pjesë e programit vjetor të punës së shkollës.

Disa nga aktivitetet kulturore, edukative në shkollë do të realizohen në bashkëpunim me vendasit dhe bashkësinë lokale dhe nëpërmjet organizatës së fëmijëve të shkollës , e cila është forcë themelore e të gjitha aktiviteteve nëpërmjet organizimit të Kryqit të Kuq, realizimit të programit ekologjik dhe do të ndërmerren aksione të llojllojshme për bashkëpunim që janë në interes të shkollës dhe bashkësisë lokale.

Në programe të veçanta janë realizuar vizita të institucioneve dhe kompanive të biznesit në rrethinën lokale, mbledhje dhe shoqërime sipas ngjarjeve të caktuara në shkollë në të cilat promovohen rezultatet e llojeve të ndryshme, promovim i aktiviteteve të projekteve, komunikim me mediumet etj.

Aktiviteteve për bashkëpunim me bashkësinë lokale

Aktiviteti irealizuar sipas programit	Koha e realizimit	Realizues	Resurset	Rezultatet e pritura dhe efektet
Takim i grupeve letrare dhe figurative	Tetor	Anëtarët e seksioneve dhe arsimtari	Krijime personale sipas zgjedhjes dhe sipas kërkesave	Bashkëpunime, shoqërime
Bashkëpunim i bashkësive të nxënësve	Tetor	Anëtarët e bashkësisë së nxënësve dhe arsimtarët përgjegjës	Programe të përgatitura	Përmirësim i punës së shkollës
Bashkëpunime dhe takime të organizatave të fëmijëve të mësimit klasor	Nëntor	Anëtarët e organizatave të fëmijëve dhe arsimtarët	Programe të përgatitura	Përmirësim i punës së shkollës
Bashkëpunim i planeve profesionale mes shkollave	Nëntor, mars	Arsimtarë, drejtori	Literaturë profesionale	Përmirësim i punës së shkollës
Pjesëmarrje nëpër manifestime të ndryshme sportive	Caktohet sipas nevojave	Anëtarët e sekcioneve dhe arsimtarët	Sipas zgjedhjes	Bashkëpunime, shoqërime
Takime dhe hepeninge muzikore	shkurt	Anëtarët e seksioneve dhe arsimtarët	Sipas zgjedhjes	Bashkëpunime, shoqërime
Bashkëpunim me shkolla të mesme dhe promovim i tyre	Maj	Nxënës, arsimtarë, drejtori	Material sipas zgjedhjes së nxënësve	Informim më i mire i nxënësve që do t'u ndihmojë në vendosjen për vazhdim të shkollimit të tyre
Shkolla dhe bashkësia lokale	Sipas nevojës	Shkolla dhe bashkësia lokale	Programet vjetor të arsimtarëve	Përforcim i bashkëpunimit
Sipas nevojës manifestime të organizuara nga komuna	Vazhdimisht	Komuna	Programe të komunës	Edukim dhe ngritje e nivelit kulturor
Mbledhje të informative për aktivitetet e bashkësisë locale dhe shoqatave	Tetor	Drejtori dhe komisione	Dokumente dhe programe	Shtim i interesit për bashkëpunim

Pjesëmarrje në festimin e Ditës së Komunës së Gazi Babës	Nëntor	Arsimtarët dhe nxënësit	Shfaqje të përgatitura me nxënësit	Afirmim i komunës
Informim i kryetarit të qytetit për festën e patronatit të shkollës	Nëntor	Drejtori dhe kryetari i këshillit të shkollës	Programe të përgatitura	Përmirësim i punës së shkollës

Aktiviteti i realizuar sipas programit	Koha e realizimit	Realizues	Resurset	Rezultatet e pritura dhe efektet
Bashkëpunim permanent me institucionet dhe sipërmarrjet	Vazhdimisht	Drejtori dhe kryetari i	Programe dhe projekte	Përmirësim i kushteve të shkollës
Edukimi i nxënësve për funksionimin e komunës	Gjatë vitit shkollor	Nxënës dhe persona nga kom,una	Programe, Projekte dhe portofoli	Thellim i diturive
Pjesëmarrje nëpër manifestime me interes publik	Vazhdimisht	Të punësuarit dhe nxënësit	Programe	Përmirësim i nivelit kulturor
Takim me kryetarin e Këshillit të komunës	Maj	Drejtori dhe kryetari i këshillit	Rregulla Ligjore	Përparim i vetëdijes demokratike
Prezentim i të arriturave të shkollës	Qershor	Drejtori dhe bashkëpunëtor ë profesional	Dokumente dhe raporte	Afirmimi i shkollës

Bashkëpunim me institucionet kulturore dhe arsimore

Për realizimin më adekuat të planit dhe programit mësimor,për njohje më të lehtë të planeve dhe përmbajtjeve mësimore janë planifikuar vizita të caktuara të objekteve dhe manifestimeve nga fusha e kulturës të cilat do ti pasurojnë njohuritë e nxënësve:

- Teatri për fëmijë dhe të rinj
- Salla e qendres kulturore
- Muzeu i qytetit të Tetovës
- Universiteti shtetëror
- Biblioteka
- Panairi i librit
- Kinematë e qytetit
- Ekspozita
- Qyteti i Borës-Mavrovë
- Muzeu arkeologjik i RMV
- Xhamia e Pashës

Bashkëpunimi me institucionet tjera edukativo-arsimore do të thotë bashkëpunim me shkollat fillore të komunës së Çairit , qytetit dhe më gjerë dhe do të zhvillohet në drejtim të aktiviteteve që i trajtojnë mësimin dhe aktivitetet jashtëmësimore siç janë garat e diturive në fusha të ndryshme, hepeninget figurative, leximet letrare dhe gara të llojllojshme sportive.

Është realizuar vizitë e institucioneve tjera në interes të mësimit:,

- ♣ posta, Kopshti zoologjik, Stacioni hekurudhor fabrika e qumshtit ALPI,VEZË SHARRI ,VRUTOKU etj.
- ♣ Vizitë e stacionit meteorologjik
- ♣ Vizitë e FSHNM
- ♣ Vizitë e Planetariumit

Vizitat arsimore jashtë shkolle për nxënësit e klasës së parë deri në klasën e nëntë arsimtarët i planifikojnë në programet e tyre mësimore. Këto vizita planifikohen dhe janë realizuar edhe me qëllim që të shfrytëzohen si resurse efektive për mësim dhe arritje të njohurive të qëndrueshme. Mes tjerash qëllime janë edhe:

- ♣ T’i zgjerojnë njohuritë për rrethinën më të afërt
- ♣ të aftësohen për vëzhgim, përshkrim, krahasim
- ♣ të aftësohen të përdorin burime të ndryshme të njohurive
- ♣ t’i zgjerojnë njohuritë e për pasuritë kulturore të atdheut të tyre
- ♣ të orientohen në hapësirë dhe kohë
- ♣ t’i zgjerojnë njohuritë

Bashkëpunimi me institucionet tjera

Bashkëpunimi i shkollës me organizatat shëndetësore është realizuar në bashkëpunim me Shtëpinë shëndetësore Poliklinika Tetovë, në kuadër të mbrojtjes së paraparë shëndetësore të nxënësve.

Në kuadër të të realizimit të projekteve të paraparados të realizohet edhe bashkëpunim me OJQ dhe shoqata të qytetarëve që i përmbajnë ato. Bashkëpunim aktiv disavjeçar realizohet me ambasadën për fëmijë Megjashi, i cili është paraparë të vazhdojë Në vazhdimësi edhe këtë vit.

Shkolla është mbështetës aktiv i sportit dhe nxënësit tonë arrijnë rezultate të dukshme në këtë fushë. Kjo ka kontribuar për krijimin e kontakteve me klubet dhe shoqatat që funksionojnë në komunën e Tetovës, takime me sportistë dhe anëtarësim në rinovimin e klubit. Bashkëpunimi me klubin e karatesë “Shkëndia”zgjat dy vjet nga kënaqësia e nxënësve. Klubi i karatesë ofron shërbimet e veta në vendin e jetesës së nxënësve që do të thotë shumë nëse merret parasysh vendpozita e vendbanimeve në krahasim me qytetin. Në qoftë se ka interes nga nxënësit dhe prindërit bashkëpunimi do të vazhdojë edhe në vitin shkollor 2023/2024.

XVIII. PROJEKTET NË TË CILAT ËSHTË E PËRFSHIRË SHKOLLA NË VITIN SHKOLLOR 2022/2023

- Projekt për implementimin e edukimit ekologjik në sistemin arsimor të Maqedonisë- mbështetur nga Shoqatat e qytetarëve OJQ, MASH dhe BZHA

- Projekt për integrimin ndëretnik- projekt i USAID , i mbështetur nga MASH dhe
- BZHA
- Projekt për femijët me nevoja ndryshe Hapni Dritaret etj

XIX. NDJEKJA DHE EVALUIMI I PROGRAMIT VJETOR PËR PUNËN E SHKOLLËS

Gjatë ndjekjes dhe evaluimit të realizimit të Programit vjetor për punën e shkollës niset nga plani për zhvillimin e shkollës, drejtimet për vetevaluim të punës së shkollës.

Drejtori dhe shërbimi profesional i shkollës parashtrojnë raport gjysmëvjetor dhe vjetor për realizimin e Programit vjetor në bazë të raporteve të arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë që janë përgjegjës në fusha të caktuara, por edhe në bazë të vëzhgimeve dhe realizimeve të veta. Këto raporte shqyrtohen dhe miratohen nga Këshilli arsimor, Këshilli i prindërve të shkollës, Këshilli i shkollës. Shembuj nga raportet dërgohet deri te shërbimi nga departamenti i themeluesit të arsimit.

SHTOJCË

Për raportin vjetor të punës së shkollës për vitin shkollor 2022 /2023

Plani vjetor për punën e drejtorit të shkollës

Puna e drejtorit ishte e drejtuar kah përparimi të gjitha segmenteve të punës edukativo-arsimore dhe realizimit të të gjitha qëllimeve dhe detyrave të edukimit dhe arsimimit.

Para se të fillon me planifikimin dhe programimin e punës, drejtorisë pari duhet të mëson dhe analizon të gjitha kushtet, gjendjet me qëllim që të përfitohet me dituri përkatëse dhe nota kualitative për atë që duhet të jetë prioritet i planifikimit.

Drejtori duhet ta organizojë punën edukativo-arsimore në shkollë. Prej tij varet organizimi dhe realizimi i të gjitha lëmenjve të strukturave të brendshme dhe të jashtme në mësim, ndërsa në mënyrë indirekte edhe punën e arsimtarëve.

Programi për punën e drejtorit është pjesë integrale programit për punën e shkollës. Mirëpo, në qoftë se nisemi nga fakti që drejtori është bartësi kryesor i këtij programi është e kuptueshme se programi për punën e drejtorit është gurthemel në të cilën do të mbështeten të gjitha programet tjera, shtojcat të cilat i lidh dhe ndërlidh të gjitha programet veç e veç.

Drejtori si udhëheqës pedagogjik në shkollë, në funksion të komponentit primare, lënda dhe përmbajtja e punës globale e ndan në dy grupe bazë punuese edhe atë

-organizim administrative

-pedagogjik-instruktive

PUNE E ORGANIZUAR ADMINISTRATIVE

Në kuadër të kësaj fushe, drejtori si organizator dhe iniciator i punës së përgjithshme në shkollë. Si organ udhëheqës i ka krahasuar udhëzimet dhe vendimet që i sjellin organet e (bordi i shkollës, organet profesionale, këshilli i arsimtarëve klasor , udhëheqësit e paraleleve, aktivet profesionale).

A	***Puna e organizuar administrative***
	Puna administrative
	Financiare
	Materiale
	Puna normative(mësim i ligjeve dhe rregullave)
	Vëzhgime
	Dhënie ndihmë
	Vlerësim dhe korrigjim
II	***Rregullimi organizativo- teknik i shkollës***
	Funksionaliteti i klasave, punëtorive, terreneve sportive, biblioteka etj.
	Parapagimi dhe shfrytëzimi i literaturës profesionale, revista pedagogjike dhe gazeta, lektyra për nxënësit, mjete mësimore dhe ndihmëse.
	Planifikimi dhe organizimi i ekskursioneve të nxënësve me karakter shkencor dhe rekreativ.
	Planifikim për vizitë të muzeve, teatrove, ekspozitave dhe të ngjashme.

III	***Puna juridiko-administrative***
	Puna me organin e udhëheqjes
	Ndihmë për përpunimin e propozim-akteve etj.
IV	***Evidenca dhe dokumentacioni***
	Udhëheqja e dokumenteve pedagogjike
	Dosje personale të arsimtarëve
	Dokumentacion për planifikimin e punës edukativo-arsimore
	Dokumentacion për përcjelljen e punës edukativo-arsimore
	Dokumentacioni për hulumtime dhe shqyrtime të realizuara në shkollë
	Dokumentacion për vizitat e realizuara në orë
B	***Puna instruktive-pedagogjike***
V	***Programore-koncepuese***
	Realizimin e programit operativ për aktivitetet në periudhën qershor-gusht
	Përcaktimi i gjendjes së përgjithshme në shkollë për realizimin e punës
	Realizimin i ndarjes së udhëheqësve të klasëve dhe ndarja e orëve
	Përgatitja e programit për punë të këshillit arsimor dhe përsosja profesionale e arsimtarëve
	Përgatitja e programit vjetor për punën e drejtorit
	Ndihmë arsimtarëve për përgatitjen e planit global dhe tematik vjetor
	Përgatitja e Programit vjetor për punën në shkollë
	Përgatitja e orarit dhe aktiviteteve të lira të nxënësve
	Përshtatja për përparimin e klimës për punë
	Bashkëpunim me organet profesionale
II	***Përcjellja e organizimit dhe realizimit të punës edukativo-arsimore dhe punëve tjera profesionale në shkollë***
	Shqyrtim i planeve dhe programeve vjetor të planifikuara për punën e procesit edukativo- arsimor
	Kontrollim i ditarëve klasor dhe librit amë
	Shqyrtim, përcjellje, udhëzim dhe mbajtja e evidencës për përpunimin e përgatitjeve ditore

	Shqyrtim, kontrollim dhe përcjellje e përgatitjeve të realizuara profesionale organizative- operative,material-teknike dhe didaktiko-metodike për aktivitet jashtëmësimore të nxënësve
	Vizita në orë Vizitë në orë udhëheheqësve klasor me qëllim që të shihet realizimi i komponentit
	Vizitë në orët shtuese dhe plotësuese Realizimi i bisedave të domosdoshme dhe konsultim, këshillim dhe dhënie ndihmë arsimtarëve për përmirësimin e gjendjes
	Udhëzim dhe përcjellje e aktiviteteve në lidhje me intensifikimin e funksionit edukativ në shkollë.
III	***Puna me arsimtarë-vëzhgim pedagogjik në mësim***
	Njoftim me strukturën e përgjithshme programore veçanërisht me ndryshimet dhe plotësimet në planet dhe programet mësimore
	Ndihmë didaktiko-metodike profesionale në realizim
	Ndihmë e menjëhershme profesionale arsimtarëve fillestarë
	Përcjellje dhe vlerësim i punës
	Punë këshillëdhënëse me arsimtarë, nxënës dhe prindër
	Vrojtim i përgatitjeve ditore të arsimtarëve për orët
	Vizitë neper orë(të rregullta, plotësuese , shtuese dhe aktivitete tjera)
	Analizë e orëve dhe konsultim me arsimtarët
	Përcjellje e realizimit të planit për përparimin e vlerësimit të shkollës
IV	***Puna me organet profesionale në shkollë***
	Njohtim me aktet ligjore përkatëse të veprimtarisë
	Planifikim dhe programim i punës së këshillit të arsimtarëve dhe realizimi i detyrave programore
	Ndihmë në planifikimin dhe realizimin e detyrave të këshillit të klasave
	Ndihmë, pjesëmarrje, dhënie udhëzime për punën e aktiveve profesionale
	Ndihmë, përcjellje e realizimit të orës së udhëheqësit të klasës
	Njohtim me aktet ligjore përkatëse të veprimtarisë
	Përcjellje e rregullt e literaturës për organizimin e punës së organeve profesionale në shkollë
	Pjesëmarrje e rregullt në të gjitha mbledhjet e e aktiveve profesionale në shkollë.
	Nxitje bisedash të përgjithshme dhe profesionale për të gjitha pyetjet e rendit të ditës në mbledhje

	Përgatitje dhe udhëheqje e mbledhjeve të Këshillit të arsimtarëve dhe përpjekje të realizohen përfundimet e miratuara
	Raportimi përpara Këshillit të arsimtarëve për masat e ndërmarra në lidhje me përparimin e BOP në shkollë
V	**Puna me nxënës dhe organizatat e nxënësve**
	Kontakt individual
	Ndihmë në konstruimin dhe punën e organizatave të nxënësve
	Ndihmë në punën me nxënësit e rinj dhe të talentuar
	Punë me nxënësit që tregojnë sjellje asociale
	Punë me nxënësit që tregojnë rezultate të dobëta
	Udhëzime dhe dhënie ndihmë për organizimin e jetës kulturore,argëtuese dhe sportive të nxënësve
	Inicim për realizimin e pushimeve dimërore dhe verore të nxënësve
	Nxitje për rregullimin estetik të hapësirës në shkollë
	Nxitje për bashkëpunim me mjedisin lokal (me organizatat e komunës)
	Nxitje për bashkëpunim me institucionet kulturore dhe organizatat nga mjedisi lokal(kinema, teatër, bibliotekë,shkollë muzikore, shtëpia e pionierëve e të ngjashme)
VI	**Përcjellje dhe zgjedhje e problemeve karakteristike edukativo-arsimore dhe dukurive tjera negative në punën e shkollës**
VII	**Puna analitiko-studimore dhe modernizimi i punës edukativo-arsimore**
	Analiza e planeve vjetor globale dhe tematike të arsimtarëve
	Vrojtim i përgatitjeve ditore të arsimtarëve
	Përpunim i analizave, raporteve të rezultateve të arritura në punën e shkollës
	Udhëzim i arsimtarëve në punën analitike në mësim dhe fusha të tjera
	Përgatitje e informacioneve për punën e organizatave të nxënësve, për mbajtjen e garave të nxënësve, për bashkëpunim me institucionet tjera edukativo-arsimore
VIII	**Bashkëpunimi me shërbimet profesionale në shkollë dhe institucionet profesionale jashtë shkolle**
	Pjesëmarrje në punën e bashkëpunëtorit profesional në shkollë gjatë programimit, përcjelljes dhe kontrollin mbi punën
	Bashkëpunim me MASH, BZHA, DIK dhe bashkësinë lokale të Republikës së Maqedonisë
	Bashkëpunim me organizata profesionale, shoqata dhe institucione.
	Sigurim i përsosjes profesionale të kuadrit arsimor nëpërmjet seminareve, kurseve, takimeve konsultative, mbajtje evidence dhe

	vrojtim në rezultatet e përsosjes
	Përcjellje e aktiviteteve të arsimtarëve në kuadër të" Mësimi dhe arsimi në shek. 21"
	Certifikim i arsimtarëve për projektin" Integrimi ndëretnik në mësim"
	Realizimin e planit të shkollës për përparimin e vlerësimit për vitin shkollor 2022/2023
	Organizim i vlerësimit ekstern në shkollë
IX	**Përsosja permanente profesionale pedagogjike-psikologjike e kuadrit arsimor, edukativ dhe kuadrove tjera profesionale**
	Kujdesi për sigurimin e shkollës me literature të nevojshme profesionale si dhe nxitje për përdorimin e saj
	Udhëzim i kuadrit edukativo-arsimor për përsosje profesionale jashtë shkolle(informata kthyese për efektet e këshillimit)
	Ndihmë enë realizimin e përmbajtjeve mësimore
	Punë individuale për përsosje personale profesionale
X	**Puna me arsimtarë, edukatorë dhe bashkëpunëtorë profesional**
	Njohtim me strukturën e përgjithshme programore, veçanërisht me ndryshimet dhe plotësimet në planet dhe programet mësimore
	Ndihmë profesionale, metodike-didaktike në realizim
	Ndihmë profesionale si dhe kyçje në detyrat e lëndës që ligjëron:arsimtarë fillestar, arsimtar i posaardhur në shkollë
	Mbështetje të punës me nxënës që tregojnë sjellje asociale
	Mbështetje të punës me nxënës që tregojnë rezultate të dobëta në mësim
	Udhëzim dhe ndihmë në organizimin e jetës kulturore-argëtuese të nxënësve
	Ndihmë në organizimin e pushimeve dimërore dhe verore të nxënësve
XI	**Bashkëpunim me prindërit e nxënësve**
	Përfshirje e prindërve në procesin e realizimit të planeve dhe programeve në shkollë
	Realizimin e,programimi dhe kujdesi për realizimin e detyrave të punës së Këshillit të prindërve
	R i bashkëpunimit me prindër
	Ndihmë në planifikimin e realizimit të mbledhje prindërore
	Organizim dhe koordinim i aktiviteteve për informim të prindërve
	Pjesëmarrje direkte në arsimimin pedagojik të prindërve
	Takime dhe biseda individuale dhe grupore me prindër
	Zbulim i prindërve të cilët mund të përfshihen dhe të kontribuojnë në realizimin e aktiviteteve të caktuara

	Informim i rregullt direkt dhe indirekt i prindërve nga udhëheqësit e klasave për jetën dhe punën në shkollë.
	Njohtimi me kohë i prindërve për rendin në shkollë.
XII	**Detyra tjera të drejtorit të realizuara**
	Ka siguruar vazhdimisht kushte materialo-teknike për punë
	Përcjellje dhe vrojtim në punën administrative-financiare në shkollë;
	Kujdesi për higjienën në shkollë;
	Përcjellje e rregullave ligjore
	Puna me organet drejtuese;
	Përgatitje dhe pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit të shkollës dhe komisionet dhe trupat e saj
	Përmirësim i klimës në shkollë

Drejtor:

/ Nazif AJDINI/

RAPORT PËR PUNËN E DEFEKTOLOGUT TË SHKOLLËS

SHFK “NAIM FRASHËRI”-TETOVË

Raport për punën e Edukatorit special për vitin shkollor 2022-23

Në përputhje me programin e përgatitur për punën e edukatorit special shkollor në SH.F.K. “ Naim Frashëri” – Tetovë, qëllimet dhe përmbajtjtet e parapara për realizim në vitin shkollor 2022-23 janë: detektimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore (NVA), mbajtja e dokumentacioneve pedagogjike dhe evidencës së nxënësve, mbështetje mësimore për nxënësit, arsimtarët dhe prindërit, punë individuale me nxënësit me NVA si dhe përfshirje në punën e shërbimit profesional të shkollës.

1. Detektimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore (NVA)

Në muajin tetor me ndihmën e shërbimit profesional dhe arsimtarëve u detektuan dhe evidentuan fëmijët me NVA në shkollë. Konkretisht, në vitin 2022/2023 në SHFK “Naim Frashëri” -Tetovë mësimin e kanë ndjekur edhe nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Përshkak vështirësive në mësim ose problemeve me sjelljen dhe adaptimin nga ana e shërbimit profesional në shkollë (pedagog, psikolog, defektolog) është ndjekur zhvillimi dhe arritjet e 20 fëmijëve prej të cilëve 12 nga mësimi klasor dhe 8 nga ai lëndor.

2. Mbajtja e dokumentacionit pedagogjik, ndjekja

Për fëmijët me NVA, të cilët kanë dokument nga struktura (objekti) i duhur mjekësor, gjatë gjithë vitit shkollorë janë mbajtur dosie të veçanta, të cilat në vete përmbajnë dokumente me vlerësimet e aftësive funksionale të fëmijës, vlerësimet nga puna individuale defektologjike, PIA, punimet nga puna individuale, observimet gjatë kohës në orë mësimore, mendimet nga prindërit dhe arsimtarët.

Për nxënësit, të cilët kanë vështirësi në realizimin dhe përvetësimin e kurrikulës së rregullt, janë përgatitur plane individuale arsimore – PIA (në bashkëpunim me arsimtarët dhe prindërit), të cilët kanë për qëllim lehtësimin e procesit arsimor te kjo kategori e fëmijëve, duke i definuar qartë qëllimet dhe metodat e punës.

3. ***Mbështetje mësimore për nxënësit, arsimtarët dhe prindërit***

Gjatë këtij viti shkollor prindërve, nxënësve dhe arsimtarëve u është dhënë mbështetje e vazhdueshme arsimore. Konkretisht, janë realizuar konsultime dhe këshilla të shpeshta me **arsimtarët** rreth mënyrës së punës dhe metodave tek fëmijët me NVA, vlerësimi (notimi), formulimi i testeve dhe socializimi tek fëmijët. Konsultime dhe këshillime për planet individuale arsimore me arsimtarët kudjestarë dhe asistëntët e nxënësve me NVA.

Me ***prindërit*** bashkëpunimi ishte i pjesërishëm, gjegjësisht janë realizuar disa takime individuale gjatë vitit shkollor, në të cilat diskutohej rreth mënyrës së punës me fëmijën, nevojat dhe qëllimet e PIA si dhe mënyrën e funksionimit të nxënësit në shkollë dhe shtëpi. Vlerësimet dhe rivlereësimet nga qendra për kategorizim KNF-së.

Nxënësit me PIA herë pas here janë observuar gjatë kohës së orëve mësimore, me qëllim që të shihet niveli i realizimit të përmbajtjeve mësimore, pranimi në klasë, përdorimi i metodave të duhura për punë gjatë kohës mësimore, si dhe detektimi eventual i disgrafisë, disleksisë apo problemeve me grafomotorikën. Me një pjesë të nxënësve është punuar në mënyrë individuale nga 2-3 herë në javë.

4. ***Puna individuale me nxënësit me NVA***

Këtë vit shkollor individualisht është punuar me 20 nxënës me NVA – 12 nxënës nga mësimi klasor dhe 8 nxënës nga mësimi lëndor. Nxënësit janë marrë para ose pas orëve mësimore në hapësirë speciale pikërisht për nevojat e tyre çdo ditë nga 40-60 minuta. Me ta janë realizuar ushtrime për riedukim psikomotorik, ushtrime për përvijim dhe grafomotorikë, orientim në kohë dhe hapsirë, lateralizim dhe njohje të pjesëve të trupit (topognozioni), janë praktikuar teknika për lexim dhe shkrim, si dhe janë përpunuar të gjitha ato përmbajtje mësimore, të cilat nxënësit më vështirë i kanë përfituar. Nxënësit tjerë janë ndjekur ose është realizuar asistencë gjatë orëve mësimore.

5. ***Përfshirja në punën e shërbimit profesional***

- Përfshirje gjatë vlerësimit të klasave të para për vitin shkollor 2023-24 dhe detektimi i çrregullimeve eventuale fizike dhe zhvillimore.
- Realizimi i mendimeve për nxënësit me NVA, si dhe udhëzim i prindit për vlerësim në qendrat përkatëse. Bashkëpunimi me qendrën për resurse Zlatan Sremec-Shkup për identifikim të nxënësve me nevoja të veçanta dhe udhëzime për prindërit në vlerësim për sigurimin e asistentëve edukativ për këta nxënës.
- Qëllimet dhe përmbajtjet e parapara për realizim nga programi vjetor janë realizuar në përputhje me kushtet dhe mundësitë për punë, si dhe në përputhje me nevojat e nxënësve dhe shkollës.

6. ***Projekte dhe aktivitete***

- Bashkëpunime me shoqatën Handimak dhe Hap pas hapi- bursa për të gjithë nxënësit me nevoja të veçanta të klasës së dytë, tretë të cilët kanë dokument nga organet përkatëse. Aplikime në projekte të reja në përpuethshmëri me planin aksionar për inkluzionin.
- Shpërndarja e bursave për nxënësit me gjendje ekonomike të dobët nga shkolla Marrif.

- Mbajtja e punëtorisë me të gjithë klasët e IX-ta- “Inkluzioni në arsim”- si ti ndihmojmë dhe ti pranojmë nxënësit me NVA.
- Bashkëpunime me student të edukimit special për pyetësorë dhe hulumtime të ndryshme në lidhje me punën me nxënësit me NVA.
- Punëtori e organizuar nga MASH për “Parandalimin e dhunës në shkolla”, në bashkëpunim me BZHA, e njëjta është desiminuar në shkollë me të gjithë arsimtarët kudjestar dhe nxënësit e shkollës.
- Trajnim nga qendra Zlatan Sremec, për vështirësitë në komunikim . me temë “Dua të jem i kuptuar”.
- “Bashkë për inkluzionin”- Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Bashkëpunime dhe aktivitete, vizitë në shkollat e tre shteteve dhe ndarja e përvojave me nxënësit me NVA. Në bashkëpunim me shoqatën CED-Maqedoni, ED GUARD-Kosovë dhe CRCA-Shqipëri.

Adile Rakipi- Edukator special i shkollës ***Qershor, 2023***

SHKOLLA FILLORE KOMUNALE “NAIM FRASHËRI” –TETOVË

Raporti i sociologes së shkollës

Periudha: Shtator- Qershor 2022\23

Aktiviteti i realizuar	Koha e realizimit	Realizatori	Përfitimi
Plotësimi librit Amzë për nxënësit e ardhur.	Janar deri qershor	Pedagogu i shkollës dhe sociologu	Pasqyrë lidhur me nr. E nxënësve të shkollës.
Plotësimi i listës së nxënësve që shfytëzojnë shtesa arsimore, ndihma sociale dhe nevoja personale.	Mars-Prill	Sociologu i shkollës	Rritja e cilësis në mësimin digjital-nxënësit përfituan Tableta
Dhënia e fletëshpërnguljeve dhe vërtetimeve për nxënësit që shfrytëzojnë shtesa arsmore, ndihma sociale.	Shtator deri qershor	Sociologu i shkollës	Lehtësimpër regjistrim në shkollë tjetër.
Punë individuale dhe	Shtator deri qershor	Sociologu i shkollës	Përmirsimi i sjelljes sociale së nx. në

këshillime me prind dhe nxënës.			shkollë.
Përgaditja e listave për kontrollimin me TIMSS, kl. IV-2,4	Shkurt	Pedagogu i shkollës dhe sociologu	Perfitimi I shkathtesive dhe shprehive per kryerjen te aktiviteteve dhe kontrollave jashte shkolles
Printimi I ditarëve elektronik nga kl. I-IX	Shtator-Qershor	Pedagogu i shkollës dhe sociologu.	Shkolla perfiton kontroll dhe mbajtje te evidencave pedagogjike ne shkolle
Përgaditje e raportit me përgjigje kthyese për 5 nx. deri te Enti për punë sociale	Shkurt-Mars	Sociologu I shkollës	Mbajtje e evidencave te sakta dhe bashkepunim me entin per pune sociale
			.
Punëtori me nx e kl. IX-1,2,3,4,5,6me temë: “Orientimi professional”	qershor	Sociologe e shkollës	Orientim më të lehtë, këshillim për rregjistrim në shkollë të mesme.
Shpërndarja e vaučerëve me vlerë prej 2000 den nga	Prill	Sociologu I shkollës	Sigurimi dhe kujdesi I nxenesve me nevoja ekonomike financiare.

Shkolla Maarif për 38 nxënës			
Trajnim me BZHA për TIMSS	Shkurt	Sociologe dhe mësueset e klasave të IV-ta.	Perfitimi I shkathtesive dhe shprehive per kryerjen te aktiviteteve dhe kontrollave jashte shkolles
Punë e dobishme shoqërore	Prill	Sociologe e shkollës	Veshëmbathje për 6 nxënës me rastin e Festes së Fitër Bajramit. Bashkëpunim me rrethin lokal me Firmën Cudo.
Përgaditja e listave për nxënësit pjesëmarës në gara shkollore, rajonale, komunale etj.	Qershor	Sociologe e shkollës	Ndarja e çertifikatave për rezultatin e arritur, motivim dhe krenari.

Sociologe: Arijeta Beqiri

RAPORT PËR PUNËN E PEDAGOGUT

NË FUND TË VITIT SHKOLLOR 2022-23

Realizues: Gzime Alili

RAPORT PËR PUNËN E PEDAGOGUT NË FUND TË VITIT SHKOLLOR 2022-23
Puna e pedagogut të shkollës si pjesë përbërëse e aktiviteteve të parapara me programin vjetor të punës së shkollës për të nxitur veprimtarin edukative – arsimore në shkollën fillore.
Qëllimi i punës pedagogjike do të jetë perceptimi dhe evidentimi i çështjeve dhe problemeve pedagogjike dhe didakto-metodologjike me të cilat përballen mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit e nxënësve gjatë punës edukative - arsimore.
Realizues: Gezime Alili

Fushat programore-përmbajtjet	Realizuesi	Koha e realizimit	Burimet dhe resurset	Aktivitetet dhe efektet
1.Planifikimi dhe pjesëmarrja në punën edukative të shkollës.				
1.1. Përgatitja, planifikimi dhe programimi në nivel shkolle.				
Përgatitja për realizimin e programit shkollor. **Planifikimi dhe përgatitja e punës së pedagogu.** **Pjesëmarrja në përgatitjen e planit dhe programit vjetor për punën e shkollës, kurrikulës shkollore (programit), të dhëna statistikore.** **Përgatitja e planit dhe programit vjetor dhe mujor për punën e pedagogut.** **Planifikimi dhe hulumtimi i projekteve.** **- Asistencë - ndihmë në planifikimin vjetor dhe mujor të punës së mësuesve.** **- Përgatitja e programit për implementimin e ekologjisë në sistemin arsimor të RMV.** **- Planifikimi i programit të kujdesit shëndetësor.**	Drejtor, Pedagog Psikologu, bashkëpunëtorët e jashtëm dhe ekipi i shkollës për përgatitjen e Programit Vjetor i ekipit për cilësin e punës në shkollë. Anëtar mësimdhënës i ekipit të inkluzionit.	Gusht Shtator	Programi vjetor dhe raporti vjetor për punën e shkollës për vitin shkollor; Raportet statistikore nga periudhat e tremujoreve Udhëzime nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Rregullore për përgatitjen e programen për punë vjetore .	Analiz e zbatimit të planeve të mëparshme dhe programit të punës së shkollës. Caktim i nevojave arsimore të mjedisit në të cilin funksionon shkolla. Efikasitet më i madh i aktiviteteve të planifikuara. Pjesëmarrje në hartimin dhe krijimin e zhvillimit afatshkurtër dhe afatgjatë të shkollës. Statistikat. Përgatitja e broshurave për prindërit dhe nxënësit. Planifikimi dhe programimi i planit vjetor të punës së shkollës, plani i punës së pedagogut. Planifikimi i aktiviteteve nga "Programi për zbatimin e ekologjisë në sistemin arsimor të RMV". Njoftimet për vaksinimet e nxënësve nga “Qendra shëndetësore” Tetovë, Monitorimi- ndjekja e shëndetit, Përgatitja e një raporti. Krijimi i zhvillimit afatshkurtër dhe afatgjatë të shkollës.

Pjesëmarje në përpilimin e: **Programit vjetor të punës së shkollës.** **Programit të punës së ekipit të inkluzionit.** **Programit të punës së bashkësisë së nxënësve.** **Programit për parandalimin e sjelljes së dhunëshme.** **Programit për orientimin profesional e nxënësve.** **Planit për punë me nxënës të talentuar.** **Plan për punë me nxënës me nevoja të vecanta.** **Programit të punës së këshillit të prindërve.** **Programit vjetor të punës së pedagogut.** **Raportit gjashtëmujor dhe vjetor për punën e pedagogut.** **Programit të edukimit mjedisor në sistemin arsimor.**	Pedagogu	Gusht Nëntor Janar shkurt	raportet për programet e realizuara nga viti paraprak	Planifikimi dhe programimi i planit vjetor të punës së shkollës, plani i punës së pedagogut. Dëshmi: është përgatitur programi vjetor për punën e shkollës. Përgatitja e plan aksional- veprimi për programin e punës së pedagogut.
1.2 Pjesmarje në:				

- Punën e organeve profesionale të shkollës. **- Këshillin e klasave.** **- Këshillin e arsimtarëve.** **- Këshillin e prindërve.** **- Aktivet profesionale.**	Pedagogu		Raportet për programet e realizuara nga viti paraprak	Pjesëmarje në përgatitjen e dokumentacionit, procedurave dhe rregullave të brendshëme- rregulloreve për shkollën. Pjesëmarje në përgatitjen e analizave dhe raporteve mbi suksesin, rregullsinë dhe sjelljen e nxënësve në të gjitha periudhat e klasifikimit. Pjesmarje në përgatitjen e raporteve.
1.3 Puna në ekipe profesionale për vetëvlerësim				
Ekipi për përgatitjen e raporteve për punën e shkollës. **Ekipi i sjelljes jo të dhunshme.** **ekipi i përfshirjes, IIE, ECO.**	Pedagogu	Gusht Nëntor Janar Shkurt	Raportet për programet e realizuara nga viti paraprak.	Pjesëmarje në përgatitjen e raporteve gjashtëmujore dhe vjetore për punën e shkollës në: Bashkësinë shkollore, Ekipi gjithëpërfshirës, Në ekipin për edukim mjedisor në sistemin arsimor.
2. PJESËMARRJE E DREJTËPËRDREJTË NË PROCESIN ARSIMOR				
2.1. TË ARRITURAT E NXËNËSVE				
Ndjekja e suksesit.	Punëtorët profesional. Pedagogu. Psikologu.	Shtator dhjetor	Dëftesa, fletë-shpërngulje. Regjistrim. Kërkesa të prindërve.	**Aktivitetet:** - Përgatitja e formularëve për monitorimin e suksesit, rregullsisë dhe sjelljes së nxënësve. - Dorëzimi për mëssimdhënësit e klasës dhe lëndës. - Përgatitja e një analize krahasuese të suksesit, rregullsisë dhe sjelljes së nxënësve në të gjitha periudhat e klasifikimit të vitit shkollor2022/23. Sigurimi i raporteve statistikore të përparimit të nxënësve.
2.2. Regjistrimi dhe puna me nxënës të sapo ardhur				

- Mbajtja e evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit për nxënësit e regjistruar dhe të ç`regjistruar.	Pedagogu. Psikologu. Drejtori.	Shtator Dhjetor	Dëftesa, fletë - shpërngulje. Pëlqime-mendime për regjistrim dhe kërkesa të prindërve.	**Aktivitetet:** Bisedë-intervistë me fëmijët dhe prindërit e tyre. -Mbajtja e evidencës pedagogjike dhe dokumentacionit për snxënësitt e regjistruar dhe të ç`regjistruar. **Efektet** Ofrimi i një trajtimi arsimor shembullor, njohja me mjedisin e ri shkollor, mbështetje për tejkalimin e vështirësive arsimore.
2.3. Të mësuarit dhe mësimi				
2.3.1.Puna me nxënës të talentuar				

Puna me nxënës të talentuar.	Psikologu Pedagogu	Shtator Dhjetor	Lista e karakteristikave të talentit. Vetëvlerësimi i interesave të aftësive.	**Aktivitetet** Pjesëmarje: - Njohja e karakteristikave të talentit në periudhat e zhvillimit - Njohja e sjelljes së jashtme - Përgatitja e një ankete për aktivitetet jashtëshkollore në bashkëpunim me mësuesit - Paraqitja e shënimeve-gjetjeve të mësuesve - Përpunimi dhe analiza e të dhënave **Efektet:** Kënaqja-plotësimi e interesave të nxënësve për të zgjeruar njohuritë në fusha të ndryshme. **Dëshmi:** Pyetësorët dhe raporti.
2.3.2. Puna me nxënës me nevoja të veçanta.	Defektologu. Psikologu. Sociologu. Pedagogu. Drejtori.	Shtator Dhjetor	Pyetësor. Instrumente. Çek lista.	**Aktivitetet:** -Identifikimi, monitorimi. -Mbështetje e mësuesve. -Punë këshilluese me mësuesit. -Bashkëpunimi me ekipin e arsimit gjithëpërfshirës. -Punë këshilluese me prindërit. -Referim në institucionet profesionale. **Efektet**: Qasje e përshtatshme ndaj nevojave individuale të nxënësve.
2.3.3. Pjesëmarrje në ekipin për arsim inkluziv.	Shërbimi profesional dhe Ekipet për Arsim Inkluziv EAI	Shtator Dhjetor	Programi i punës. Raporti.gjashtëmujor mbi punën e ekipit gjithëpërfshirës. Materiale profesionale.	**Aktivitetet** Pjesëmarrja në përgatitjen e një programi pune Pjesëmarrja në punë **Efektet:** Mbështetja e nxënësve dhe mësuesve për të punuar me nxënësit me nxënës me nevoja të veçanta.

2.4. Përkrahja e nxënësve				
2.4.1. Pregaditja e analizave komparative-krahasuese për të arriturat e nxënësve	Pedsgogu Psikologu	Nëntor Janar	Raporti i gjysëmvjetorit	**Aktivitetet:** Mbledhja e të dhënave nga mësuesit. **Efektet** Bëhen analiza krahasuese të arritjeve të nxënësve në lëndë.
2.4.2. Punë këshilluese me nxës me vështirësi (të grupeve të margjinalizuara)	Shërbimi profesional Drejtori Arsimtarët	Shtator-maj	Diskutime Punë këshilluese	**Aktivitetet**: Pjesëmarrja në: Bisedë me nxënësit,bisedë me mësimdhënësit, bisedë me prindërit. Rekomandime për përmirësim,mbajtja e shënimeve. **Efektet** Krijimi i kushteve për përmirësimin e sjelljes dhe rregullsisë.
2.4.3.Punë këshilluese me kujdestarët e klasëve për përmirësimin e gjendjes së nxënësve më vështirësi në mësim.	Psikologu Pedagogu.	Shtator-maj	Diskutime Punë këshilluese.	**Aktivitetet:** Bisedë me mësimdhënësit. Rekomandime për përmirësim. Mbajtja e shënimeve. **Efektet** Inovacioni dhe përmirësimi i efikasitetit të punës edukative.
2.4.4. Puna me nxënës me nevoja të veçanta. Puna me nxënës me vështirësi në të nxënë. Perceptimi, inkurajimi,	Nxënësit Arsimtarët Shërbimi profesional Drejtori	Në kontinuitet tërë vitin.	Lista evidentuese Pyetësor Bisedë	**Aktivitetet:** Identifikimi i nxënësve me nevoja të veçanta. Puna me nxënës që po përballen me dështim. Zhvillimi i vëzhgimeve, raporteve. Mundësimi që nxënësit për të mësuar në mënyrë të pavarur.

inkurajimi dhe ndjekja e nxënësve të talentuar.				Shpërndarje e materialeve për teknikat e të mësuarit. Konsultimet me mësuesit dhe prindërit dhe udhëzimet për punën me këta nxënës. Monitorimi i progresit të nxënësve. Përfshirja në aktivitetet e projektit, pjesëmarrja në konkurse dhe ngjarje. **Efektet** Ndihmë e organizuar për studentët për të zhvilluar marrëdhënie pozitive sociale në shkollë dhe klasë. Krijohen masa për rritjen e sigurisë së nxënësve. Bëhet këshillimi i vazhdueshëm me nxënësit. Krijimi për punë cilësore me nxënës të talentuar.
2.4.5. Nxënësi më i mirë i gjeneratës dhe nxënësit më të mirë të gjeneratës.	Pedagogu Psikologu Sociologu	Qershor	Mbledhja e materialeve-dëshmive	**Aktivitetet:** Dorëzimi dhe mbledhja e formularëve nga mësuesit Mbajtja e shënimeve (mbledhja e provave nga studentët) Pjesëmarrja në punën e komisionit përzgjedhës të studentëve **Efektet:** Motivimi i nxënësve për arritje të larta në mësimdhënie dhe aktivitete jashtëshkollore dhe afirmimi i shkollës
2.4.6. Punë më Bashkësin e nxënësve të shkollës.	Pedagogu Psikologu Anëtarët e bashkësisë së nxënësve Parlamenti i nxënësve.	Shtator Dhjetor		**Aktivitetet:** Pjesëmarrja në punën e komunitetit të shkollës Përfshirja e nxënësve në aktivitete jashtëshkollore sipas projekteve të planifikuara Monitorimi i realizimit **Efektet** Përfshirja e nxënësve në punën e shkollës

2.4.7. Eko programi Planifikim i programit.	Pedagogu Koordinatori programi-pedagog Kryetar i Bordit Eco Bashkëpunëtorët Mësimdhënësit e përgjegjshëm. Nxënësit	Shtator Dhjetor		**Aktivitetet:** Ngritja e një bordi eko Krijimi i një rrjeti eko (eko ekipe në nivel të çdo klase) dhe caktimi i detyrave. -Analiza e gjendjes së mjedisit. - Plani i aktiviteteve. - Aktivitetet sipas Kalendarit Ekologjik. - Realizimi i fushatave të aksioneve. - Monitorimi dhe vlerësimi **Efektet:** Edukimi mjedisor i realizuar në procesin arsimor -Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe punës në shkollë Inkurajimi i studentëve dhe stafin për të vepruar në mënyrë mjedisore. **Dëshmi:** Plani i aktiviteteve,anketa,raporte,proces verbalet.
2.5. Klima shkollore				
2.5.1. Përcjellja e organizimi të mësimit në orët mësimore, zbatimi i teknikane mësimore dhe TIK – u në mësim.	Pedagogu	Shtator Dhjetor		**Aktiviteti:** Konsultimet me mësuesin për qëllimin e vizitës. Punë këshilluese me një mësues. Mbajtja e shënimeve. Koordinimi i aktiviteteve të ndërmarra nga mësuesit. **Efektet** Nxënësit të motivuar për arritje më të larta.
